

Katalogu i publikimeve

Banka e Shqipërisë

2006

p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



PËRMBAJTJA

HYRJE	5
BULETINI EKONOMIK	7
ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË	8
MATERIALE DISKUTIMI	12
PARAKUSHTET PËR SHËNJESTRIMIN E INFLACIONIT NË SHQIPËRI	15
KONFERENCA VI "TREGJET FINANCIARE RAJONALE DHE STABILITETI FINANCIAR – NJË KONCEPT MIDIS SOVRANITETIT KOMBËTAR DHE GLOBALIZIMIT", TIRANË, 30 - 31 TETOR 2006	22
BOTIME EDUKATIVE	32
FLETËPALOËSJE PËR PRODUKTET E BANKAVE TREGTARE	32
Ç'ËSHTË PËR JU STABILITETI I ÇMIMEVE?	32
BANKAT QENDRORE TË RAJONIT	32
PËRSE DUHET TË KËNI NJË BUXHET PERSONAL?	33
DEPARTAMENTET NË BANKËN E SHQIPËRISË	33
BORXHI DHE KREDIA = NJË ÇËSHTJE INTERESI	33
NË PRITJE TË REGJISTRIT TË KREDIVE	33
PUBLIKIME PERIODIKE	34
RAPORTI VJETOR	34
RAPORTET E POLITIKËS MONETARE	34
RAPORTI STATISTIKOR	35
BULETINI ZYRTAR	35
RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES	35
BULETINI VJETOR I BILANCIT TË PAGESAVE	36
ARTIKUJ TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË TË PUBLIKUAR NË PERIODIKË TË NDRYSHËM	36



p u **b** l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë

HYRJE

Katalogu i Publikimeve të Bankës së Shqipërisë 2006, është një përmbledhje e kolanave periodike, e raporteve periodike ose jo; dhe e të tjera botimeve që kemi përgatitur për bankat tregtare, për institucione të ndryshme e individë, për publikun e gjerë në përgjithësi, brenda e jashtë vendit, gjatë këtij viti.

Shpërndarja e tyre bëhet falas, sipas një liste e cila përfshin administratën publike, bankat e nivelit të dytë, institucione të ndryshme dhe këdo tjetër që është i interesuar për to.



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



Banka e Shqipërisë boton një sërë publikimesh të cilat janë me interes për profesionistët si në fushën e biznesit, në atë të bankingut, për akademikët dhe për publikun e thjeshtë. Duke filluar që nga viti 2005. Titujt e tyre janë përmbledhur në një katalog.

BULETINI EKONOMIK

Buletini Ekonomik përmbledh analiza, vlerësime që kanë të bëjnë me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë si dhe informacione të ndryshme mbi sistemin bankar. Ky publikim ka një frekuencë tremujore dhe përmban: deklaratat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, të cilat përpilohen në zbatim të kërkesave të ligjit në fuqi "Për Bankën e Shqipërisë" si deklarata për politikën monetare, opinioni i pavarur mbi gjendjen e ekonomisë shqiptare, deklarata të bilancit të pagesave; prezencën e administratorëve të Bankës së Shqipërisë në publik; artikuj të ndryshëm që trajtojnë çështje ekonomike, financiare e juridike; rezultate të vrojtimeve statistikore të kryera nga Banka e Shqipërisë; të dhëna statistikore mbi sistemin bankar; situatën monetare dhe ekonominë reale; listën e bankave të nivelit të dytë që kanë marrë licencë për të operuar në Republikën e Shqipërisë, adresat dhe kontaktet e tyre, listën e zyrave të këmbimit valutor që kanë marrë licencë nga Banka e Shqipërisë dhe adresat e tyre; strukturën organizative dhe drejtuesit e Bankës së Shqipërisë (anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe drejtorët e departamenteve).



ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Buletini Ekonomik, Vëllimi 9, nr. 1, mars 2006

INVESTIME TË HUAJA DIREKTE. SHËNIME
METODOLOGJIKE.

ARGITA FRASHËRI, Përgjegjëse e Zyrës së Bilancit të
Pagesave, Departamenti i Statistikës;
ANJEZA HOBDARI, Specialiste, Departamenti i Statistikës.

Në Shqipëri, përveç përparësisë për hartimin e një kuadri institucional për nxitjen e investimeve të huaja në vend, një domosdoshmëri e kohës është matja e saktë e tyre. Përmes një kuadri gjithëpërfshirës teorik, ky material ofron njohjen me konceptet dhe përkufizimet e IHD-ve, përbërësit e tyre, format me të cilat prezantohen e deri tek burimet dhe metodat e mbledhjes së informacionit. Gjithashtu, në të diskutohen mekanizmat institucionalë të raportimit të të dhënave, të cilët janë thelbësorë në garantimin e cilësisë të tyre.

Buletini Ekonomik, Vëllimi 9, nr. 2, qershor 2006

VLERËSIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË VENDET
MË EKONOMI NË ZHVILLIM TË EVROPËS LINDORE: RASTI
I SHQIPËRISË.

ENDRITA XHAFERAJ, Specialiste, Departamenti i Mbikëqyrjes.

Investimet e huaja botërore janë rritur ndjeshëm gjatë viteve 1995-2000, ndërkohë që pas vitit 2000 kanë rënë me të njëjtin ritëm. Shpërndarja e investimeve të huaja në vendet në zhvillim nuk është e njëjtë dhe disa prej tyre e kanë më të vështirë se disa vende të tjera, që të tërheqin investitorë të huaj. Ky material analizon zhvillimin dhe shpërndarjen e investimeve të huaja direkte në vendet e Evropës Juglindore, duke i krahasuar ato me vendet e Evropës Qendrore dhe



Lindore, me fokus të veçantë zhvillimin dhe shpërndarjen e tyre në Shqipëri. Gjithashtu, në këtë material, analizohen burimet dhe mundësitë e Shqipërisë, bashkë me pikat e saj të dobëta, me qëllim përcaktimin e ndikimit të tyre në gjendjen aktuale të investimeve të huaja hyrëse, si dhe prezantimin e disa strategjive, që do të bëjnë të mundur shtimin e tyre në të ardhmen.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI (MITI FISKAL 2004).
ARGITA FRASHËRI, Përgjegjëse e Zyrës së Bilancit të
Pagesave, Departamenti i Statistikës.

Në këtë vrojtim do të gjeni përcaktime dhe metodologji të lidhura me konceptin e IHD-ve, si dhe metodën e ndjekur për vlerësimin e stokut të kapitalit të huaj. Analiza e rezultateve të vroitimit është ndarë në dy seksione bazë, në të cilat trajtohen përkatësisht: karakteristikat numerike të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët, që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri si dhe karakteristikat sasiore të IHD-ve, që kanë të bëjnë me vlerësimin e stokut të kapitalit, sipas vendit të origjinës dhe me shpërndarjen e tij, sipas sektorëve të ekonomisë. Italia dhe Greqia vlerësohet të jenë investitorët kryesorë në Shqipëri, ndërkohë që, fluksi i kapitalit të huaj në vend është tërhequr kryesisht nga sektori i ndërmjetësimit monetar dhe financiar, sektori i industrisë përpunuese dhe ai i telekomunikacionit.

ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË PROCESIN E
INTEGRIMIT EVROPIAN.

ELVIS ÇIBUKU, Specialist, Departamenti i Marrëdhënieve me
Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit.

Në këtë material autori trajton disa prej çështjeve dhe detyrave kryesore që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim



Asociimit për Bankën e Shqipërisë. Kjo marrëveshje, e cila u nënshkrua në datën 12 qershor 2006, synon të afrojë Shqipërinë me BE, duke pasur si qëllim përfundimtar anëtarësimin. Marrëveshja reflekton drejtimit kryesore të kriterëve politike, ekonomike dhe ligjore, të nevojshme për anëtarësimin e një shteti në Bashkimin Evropian (Kriteret e Kopenhagenit). Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë si institucion që krahas ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit të këmbimeve valutore, tregut të brendshëm financiar dhe sistemit të pagesave në Shqipëri, është përgjegjëse për adoptimin e standardeve në fushat e stabilitetit makroekonomik, lëvizjes së lirë të kapitalit dhe të pagesave rrjedhëse, si dhe në atë të ofrimit të shërbimeve bankare.

Buletini Ekonomik, Vëllimi 9, nr. 3, shtator 2006

ÇËSHTJE TË BASHKIMIT MONETAR EVROPIAN DHE
KRITERET E PAKTIT TË RRITJES DHE STABILITETIT.
BLEDAR HODA, Specialist, Departamenti i Politikës Monetare.

Kjo trajtesë fokusohet në një vlerësim të kuadrit të politikave ekonomike të Bashkimit Monetar Evropian, veçanërisht të kriterëve të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes (ekonomike), ndryshe SGP. Materiali shtjellohet si vijon: Së pari, vlerësohet racionaliteti i një monedhe të përbashkët. Më tej tentohet një përmbledhje e përfitimeve afatgjata ndërsa trajtohet kostoja afatshkurtër e politikës monetare të përbashkët. Në pjesën e tretë, synohet mbështetja e nevojës së përfshirjes së dy treguesve thelbësorë makroekonomikë - rritjes ekonomike dhe nivelit të borxhit kombëtar- të përshtatur me nivelin e zhvillimit të vendeve anëtare në hartimin e këtij Pakti. Së fundi, theksohet qëndrimi se një model statik, sikurse SGP, mund të mos jetë optimal për të gjitha vendet



anëtare të BE. Politikat ekonomike nën këtë model, kanë hapësira për masa specifike për vendet anëtare, në përputhje me nivelin rajonal të zhvillimit.

Buletini Ekonomik, Vëllimi 9, nr. 4, dhjetor 2006

VENDET NË TRANZICION DHE SHQIPËRIA
ELVANA TROQE, Specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.

Zhvillimi ekonomik i vendeve në tranzicion, gjatë këtyre viteve të fundit, ka qenë i kënaqshëm. Performanca pozitive, shpesh më e lartë se ajo e vendeve të zhvilluara, ka ndihmuar në ngushtimin e hendekut të zhvillimit ekonomik midis këtyre vendeve. Edhe Shqipëria si një ndër vendet e tranzicionit, gjatë viteve të fundit ka patur ritme të kënaqshme rritjeje. Por, zhvillimi ashtu si në mjaft vende të tjera mund të përballet edhe me rreziqe. Për të përballuar sa më mirë situatat e pafavorshme, një rëndësi të veçantë marrin reformat strukturore, të cilat mund të shërbejnë si bazë për ndërtimin e një ekonomie sa më të mirë dhe të qëndrueshme. Në këtë material, analizohet pozicionimi i Shqipërisë midis vendeve më të zhvilluara të këtij rajoni, përsa i përket progresit në reforma dhe shtrohen disa nga sfidat e momentit, me të cilat përballet vendi, në rrugën për ruajtjen apo zhvillimin e mëtejshëm ekonomik.

MBI GJETJET E MISIONIT ROSC PËR SHPËRNDARJEN E TË DHËNAVE STATISTIKORE MARS – PRILL 2006.

HILDA SHIJAKU, Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave Financiare;
KLITI CECA, Drejtor i Departamentit të Statistikës.

Materiali në vijim jep në mënyrë të përmbledhur gjetjet e Misionit ROSC për shpërndarjen e të dhënave statistikore,

i cili vizitoi Shqipërinë gjatë periudhës mars – prill 2006. Misioni vlerësoi pozitivisht progresin e bërë në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave kombëtare që prej vitit 2000. Gjetjet e misionit dhe rekomandimet e lëna për përmirësimin e kuadrit statistikor në Shqipëri, përbëjnë tashmë pjesën kryesore të planeve të ardhshme për zhvillim të tre agjencive statistikore kryesore në vend: INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

ANALIZË E AKTIVITETIT DEPOZITUES DHE KREDITUES PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2006.
ERJONA SULJOTI, Përgjegjëse Zyre, Sektori Financiar;
KLODIANA ISTREFI, Kryespecialiste;
ELVANA TROQE, Specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.

Bankat tregtare kanë patur një aktivitet të suksesshëm gjatë gjithë vitit 2006, si në thithjen e depozitave ashtu dhe në dhënien e kredive. Një ecuri e tillë pritet me optimizëm edhe për pjesën e parë të vitit 2007, gjatë së cilës parashikohet të ketë një rritje të depozitave dhe interesave në valutë. Performanca e aktivitetit depozitues është paraqitur e balancuar, si për lekun ashtu edhe për valutën, gjatë gjithë vitit. Ndërsa aktiviteti kreditues, demonstroi një performancë më të mirë të kreditimit në lekë. Në përgjigje të një kërkesë më të lartë për kredi që vjen nga individët dhe biznesi i vogël, bankat po ndërtojnë strategji dhe po prezantojnë produkte të reja.

MATERIALE DISKUTIMI

TRANSPARENCA E BANKËS SË SHQIPËRISË
SOFIKA NOTE, Specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Transparenca është bërë një nga shtyllat institucionale më të rëndësishëm të politikës monetare, së cilës Banka



e Shqipërisë i ka kushtuar një vëmendje gjithmonë në rritje. Ky material synon të japë një matje sasiore të transparencës së Bankës së Shqipërisë, duke e krahasuar atë me bankat qendrore të vendeve të zhvilluara. Gjithashtu, materiali ofron edhe një përpjekje për të vlerësuar dimensionin real të transparencës dhe shkallën e të kuptuarit nga publiku.

INFLACIONI BAZË: MATJA DHE LIDHJA E TIJ ME AGREGATËT MONETARË

EVELINA ÇELIKU, Zëvendës drejtoreshë, Departamenti i Kërkimeve.

Në këtë material parashtrihen disa kritere teorike dhe praktike, ekonomike dhe statistikore, mbi efektshmërinë e matjes dhe të përdorimit të inflacionit bazë nga bankat qendrore dhe në veçanti nga Banka e Shqipërisë; sugjerohet metoda optimale e llogaritjes së tij në rastin tonë. Konkludohet se metoda e mesatareve të trimuara është ajo që na ofron matjen më të përshtatshme. Duke shkuar më tej, studimi teston këtë matje edhe me anë të lidhjes së inflacionit bazë me agregatët monetarë, duke hedhur bazat e parashikimit të tij në një të ardhme të afërt.

PARASHIKIMI I BILANCIT TË PAGESAVE

DIANA SHTYLLA, Përgjegjëse e Sektorit të Bilancit të Pagesave, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës;
ELVIRA SOJLI, Specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Në mënyrë që një shtet të mundet të mbulojë ripagimin e borxhit të jashtëm, janë të nevojshme suficite në bilancin e pagesave. Ky studim përqendrohet në ndërtimin e modeleve ekonometrike strukturore dhe jostrukturore, për të gjithë zërat e bilancit të pagesave. Nga projeksionet e kryera rezultojnë se fluksi i deritanishëm i financimeve

të deficitit korent, mund të jetë i pamjaftueshëm për ta mbuluar këtë deficit dhe nevojiten prurje më të mëdha kapitale dhe financiare.

KURSI REAL EFEKTIV I KËMBIMIT NË SHQIPËRI: KONCEPTET DHE MATJA E TIJ.
ILIR VIKA, Përgjegjës i Sektorit të Modelimeve, Departamenti i Kërkimeve.

Kursi real efektiv i këmbimit (REER) është vlera e jashtme e monedhës së një vendi, kundrejt monedhave të partnerëve të tij më të rëndësishëm dhe është treguesi më i përdorur për matjen e konkurrencës në tregtinë ndërkombëtare. Qëllimi i këtij studimi është matja e kursit real dhe efektiv të këmbimit të monedhës shqiptare, lekut. Në fillim, prezantohen disa nga propozimet kryesore lidhur me përkufizimin e drejtë të kursit real të këmbimit. Pas diskutimit mbi avantazhet dhe disavantazhet që mbart secila mënyrë llogaritjeje e REER, autori mundohet të ndërtojë seritë e kursit real efektiv të këmbimit në Shqipëri, për të parë tendencën vlerësuese apo zhvlerësuese në terma realë të lekut dhe se sa i luhatshëm ka qenë ai.

NJË VLERËSIM I ZËVENDËSIMIT TË MONEDHËS NË EKONOMINË SHQIPTARE
ELVIRA SOJLI, Specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Në këtë studim, autori ndërton një metodologji për të matur zëvendësimin e monedhës në ekonominë shqiptare, duke përdorur depozitat në valutë të huaj dhe një vlerësim të parasë së huaj në qarkullim. Nga rezultatet e përfuara, vërehet një prirje rritëse e zëvendësimit të monedhës gjatë periudhës 1998-2002 dhe arritja e një niveli maksimal, prej 36 për qind.



A ËSHTË KËRKESA PËR PARA NË SHQIPËRI E QËNDRUESHME? NJË VËSHTRIM ALTERNATIV.
MANJOLA TASE, Specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Kërkesa reale për M2 dhe M3 duket të jetë funksion i qëndrueshëm i PBB real dhe eventualisht, i normës reale të interesit për bonot e thesarit. Duke kaluar nga M2 në M3, përafresi i elasticitetit të kërkesës për para ndaj të ardhurave, rritet. Kërkesa reale për M1 nuk duket të jetë e qëndrueshme. Duke qenë se qëndrueshmëria e kërkesës për para është parakusht i zbatimit të regjimit të shënjestrimit monetar dhe agregati monetar i shënjestruar në Shqipëri është M3, rezultatet sugjerojnë se regjimi aktual i shënjestrimit monetar, i zbatuar nga Banka e Shqipërisë është deri-diku i përshtatshëm.

PARAKUSHTET PËR SHËNJESTRIMIN E INFLACIONIT NË SHQIPËRI

FJALA E KRYETARIT TË FORUMIT TË HAPUR.
MARKO ŠKREB, ish-Guvernator i Bankës Kombëtare Kroate.

Në fjalën e tij të hapjes, z. Škreb përmend ndryshimet e mëdha që ka bërë Shqipëria, gjatë 5 vjetëve të fundit. Këto ndryshime, shprehet ai, nuk janë vetëm në aspektin viziv, por edhe përsa i përket politikës monetare dhe tregut financiar. Gjithashtu, ai thekson faktin se Shqipëria është një vend me ecuri të shpejtë reformash.

MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE.
ERALD THEMELI, Zëvendësdrejtor i Departamentit të Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

Në këtë kumtesë autori përshkruan elementet e marrëdhënieve institucionale ndërmjet BSH-së dhe

institucioneve ose aktorëve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në ekonomi, në kontekstin e regjimit të ardhshëm të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Kumtesa identifikon rritjen e transparencës dhe rritjen e eficiencës të politikës monetare, si udhëheqës në ndërtimin e këtyre marrëdhënieve, duke paraqitur një listë të detajuar të hapave që duhen ndërmarrë. Një vëmendje e veçantë i kushtohet detyrave rregullatore dhe mbikëqyrëse të BSH-së, në pjesë të caktuara të sistemit financiar shqiptar.

MUNDËSI TË REJA NË BASHKËPUNIMIN INSTITUCIONAL
NDËRMJET QEVERISË DHE BANKËS SË SHQIPËRISË.
RIDVAN BODE, Ministër i Financave të Shqipërisë.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në përcaktimin e objektivave, të pjesëmarrjes dhe të përgjegjësisve merr një rëndësi edhe më të madhe në procesin e adoptimit të shënjestrimit të inflacionit. Banka e Shqipërisë, për misionin që i jep ligji dhe rolin që luan në ekonominë e vendit, përbën për Qeverinë një partner të privilegjuar. Detyrimi ligjor i këtij bashkëpunimi, si dhe përvojat përgjithësisht pozitive në këtë fushë, kanë nevojë të njohin një nivel të ri. Autori thekson rëndësinë e bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera qeveritare, sidomos me Ministrinë e Financave, si faktor kryesor në programimin, mbështetjen dhe garantimin e stabilitetit makroekonomik.

KOMENTE ME FOKUS TË VEÇANTË MBI MARRËDHËNIET
INSTITUCIONALE.

SERVAAS DEROOSE, Drejtor i Makroekonomisë për Eurozonën dhe BE-në në Drejtorinë e Përgjithshme për Çështje Ekonomike dhe Financiare (DG ECFIN) të Komisionit Evropian.

Në kumtesën e tij, autori thekson faktin se për të patur një adoptim të suksesshëm të regjimit të shënjestrimit të



inflacionit, është i domosdoshëm angazhimi i autoriteteve përkatëse dhe aftësia për të planifikuar dhe kryer ndryshimet e nevojshme institucionale. Gjithashtu, me qëllim parandalimin e humbjes së besimit dhe eventualisht, dobësimin e sistemit monetar, përpara fillimit të adoptimit formal të shënjestrimit të inflacionit, duhen përbushur një sërë kushtesh paraprake. Në këtë kuadër, z. Deroose jep disa mendime mbi katër çështje kryesore: parakushtet e adoptimit të këtij regjimi, kanalet e transmetimit monetar, marrëdhëniet me Qeverinë dhe organet e tjera të sektorit publik, dhe stabilitetin financiar.

KOMENTE MBI MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE.
RADOVAN JELAŠIĆ, Guvernator i Bankës Kombëtare të Serbisë.

Z. Jelašić, në fjalën e tij, i referohet eksperiencës së Serbisë, duke theksuar në veçanti lidhjen ndërmjet rritjes ekonomike dhe inflacionit. Gjithashtu, ai jep disa propozime konkrete lidhur me marrëdhëniet institucionale dhe kanalet e transmetimit të politikës monetare. Në këtë kuadër, autori thekson faktin se disa prej kërkesave të nevojshme për fillimin e shënjestrimit të inflacionit janë edhe mbështetja nga ana e Qeverisë, komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave; dhe ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe publikut.

REGJIMI I SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT.
BLEDAR HODA, Specialist, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

Në fjalën e tij, autori paraqet regjimin e shënjestrimit të inflacionit në aspektin e objektivit kryesor sasior, stabilitetit të çmimeve, dhe të zbatimit të politikës monetare, metodat e parashikimit si dhe çështje të tjera të lidhura me hartimin

e kuadrit operacional të politikës monetare. Përveç këtyre, ai thekson faktin se regjimi i shënjestrimit të inflacionit, kërkon mbajtjen e një regjimi luhatës të kursit të këmbimit dhe shmangien e financimit të huamarrjes së brendshme, në përputhje me standardet e vendeve më të zhvilluara. Këto bëjnë që Shqipëria të jetë më e mbrojtur ndaj faktorëve të shock-ut ekonomik, krahasuar me rastet kur ekziston një regjim “fiks” i kursit të këmbimit.

KOMENTE MBI REGJIMIN E SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT.
BILL ALLEN, Ekonomist i Lartë, Brevan Howard Asset Management LLP dhe ish-Drejtor i Bankës së Anglisë.

Autori e nis fjalën e tij me disa sugjerime mbi kuadrin e përgjithshëm të marrëdhënieve institucionale të bankës qendrore me institucionet e tjera, dhe komenton gjerësisht mbi aspektet teknike të zbatimit të politikës monetare. Midis të tjerave, ai thekson rëndësinë e pavarësisë së institucionit të statistikave, në funksion të ruajtjes së kredibilitetit të bankës qendrore, si dhe përgjegjësinë e bankës qendrore për të shpjeguar faktorët që çenojnë përmbushjen e objektivit kryesor. Hartimi i kuadrit të politikës monetare, duhet t'i përgjigjet më tepër përvojës së vet Bankës së Shqipërisë sesa një modeli fiks (statik). Autori favorizon përcaktimin e objektivit pikësor të inflacionit kundrejt objektivit interval. Gjithashtu, ai sugjeron se banka qendrore duhet të lejojë më tepër hapësirë për përshtatjen graduale të kuadrit të politikës monetare në përputhje me tendencat e ardhshme të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare.

KOMENTE MBI REGJIMIN E SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT.
MÅR GUDMUNDSSON, Zëvendësdrejtor i Departamentit Monetar dhe Ekonomik në Bankën për Rregullime Ndërkombëtare.



Fillimisht, autori bën një përmbledhje të aspekteve teorike dhe të literaturës së aplikuar të regjimit të shënjestrimit të inflacionit në vende të ndryshme. Më pas, ai krahason situatën e Shqipërisë kundrejt kuadrit teorik, duke i bazuar sugjerimet e tij në përvojën ndërkombëtare të aplikimit. Kështu, ai mban një qëndrim në favor të prioritetit të objektivit të inflacionit, argumenton avantazhet komunikuese të formës pikësore të objektivit prej 3 për qind, si dhe mbron horizontin kohor dyvjeçar të parashikimit të inflacionit. Problemi i objektivit të rritjes ekonomike, sipas autorit, mund të zgjidhet nëpërmjet një qëndrimi fleksibël të bankës qendrore vetëm në periudhën afatshkurtër për t'iu përgjigjur goditjeve ekonomike, ndërsa sugjeron një kurs të lirë në tregun valutor dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit financiar për të mundësuar parashikimin e normave të interesit në treg.

KOMENTE MBI REGJIMIN E SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT.
HANS-JOACHIM KLÖCKERS, Drejtor i Zhvillimeve
Ekonomike, Banka Qendrore Evropiane, Frankfurt.

Në kumtesën e tij, autori thekson vlerën e adoptimit të një regjimi të ri të politikës monetare, si një hap i rëndësishëm drejt arritjes së një stabiliteti të qëndrueshëm të çmimeve. Tiparet kryesore të këtij regjimi janë (a) përqendrimi në të vetmin objektiv që është stabiliteti i çmimeve; dhe (b) dispozita ligjore të rëndësishme që rregullojnë pavarësinë e bankës qendrore në zbatimin e mandatit të saj, përfshirë ndalimin e financimit të deficitit buxhetor të Qeverisë.

PROCESI I VENDIMMARRJES SË POLITIKËS MONETARE.
DORIANA LAMA, Përgjegjëse e Zyrës së Tregjeve Financiare,
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.

Në fjalën e saj, autorja përmend shumëllojshmërinë

e strukturave të qeverisjes në disa prej vendeve që kanë adoptuar regjimin e shënjestrimit të inflacionit. Në këtë kuadër, ajo thekson faktin se strukturat e adoptuara i janë përshtatur historisë kombëtare, kuadrit kombëtar ligjor dhe mënyrës specifike të ndërtimit të besueshmërisë së institucionit në vendet përkatëse. Gjithashtu, bëhen disa propozime, të cilat kanë për qëllim rritjen e efikasitetit të politikës monetare dhe ruajtjen e autonomisë, përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë së nevojshme të bankës, të cilat do të mbështesin sistemin e shënjestrimit të inflacionit.

KOMENTE MBI PROCESIN E VENDIMMARRJES.
TONNY LYBEK, Ekonomist i lartë në Fondin Monetar
Ndërkombëtar, Washington DC.

Në fjalën e tij, z. Lybek jep disa komente mbi strukturat qeverisëse të bankave të ndryshme qendrore, duke vendosur Shqipërinë në këtë kontekst. Ai bën dallimin midis katër llojeve të ndryshme të autonomisë të një banke qendrore. Autori e mbyll fjalimin me propozimin e krijimit të një Komiteti të Politikës Monetare, i cili përforcon kontrollin dhe ekuilibrat brenda Bankës së Shqipërisë.

KOMENTE MBI PROCESIN E PROPOZUAR TË
VENDIMMARRJES NË BANKËN E SHQIPËRISË.
WILLIAM H. STONE, Zëvendëspresident i Parë në Bankën e
Rezervës Federale të Filadelfias.

Në këtë fjalim, autori shpreh disa mendime dhe bën disa komente mbi procesin e propozuar të vendimmarrjes, pas adoptimit të shënjestrimit të inflacionit. Më konkretisht, ai paraqet vlerat që ka krijimi i Komitetit të Politikës Monetare si dhe disa prej karakteristikave dhe kualifikimit, që duhet të kenë anëtarët e këtij komiteti.



KOMENTE MBI STRUKTURËN INSTITUCIONALE TË
SHËNJESTRIMIT TË INFLACIONIT NË SHQIPËRI.
ZDENĚK TŪMA, Guvernator i Bankës Kombëtare Çeke.

Në fjalën e tij, autori bën disa komente mbi çështje të rëndësishme të vendimmarrjes nën regjimin e shënjestrimit të inflacionit, duke ndarë me pjesëmarrësit e tjerë eksperiencën e Bankës Çeke, në këtë drejtim. Ai shprehet se politika monetare është pa asnjë dyshim një nga instrumentet më të fuqishme të bankës qendrore për administrimin makroekonomik. Ndërsa sfondi teorik për vendosjen e objektivit të inflacionit është i mirëpërcaktuar, detyra e përgatitjes praktike të drejtimit të politikës monetare, me qëllim arritjen e këtij objekti në një mënyrë efikase është pa dyshim mjaft e vështirë. Kështu, krijimi i një sistemi funksionues për vendimmarrje është pika e parë në axhendën e çdo banke qendrore, e cila përpigjet të krijojë një kornizë të shëndoshë të politikës monetare.

FJALË PËRSHËNDETËSE.

MALCOLM KNIGHT, Drejtor i Përgjithshëm i BIS.

Në fjalën e tij, autori përmend tre elemente-kyçe përsa i përket bankingut qendror. Së pari, ai thekson mandatin e qartë dhe objektivat e përcaktuar; së dyti, pavarësinë e mjaftueshme për të përmbushur funksionet e mandatit; dhe së treti, përgjegjshmërinë për veprimet dhe administrimin e burimeve. Autori gjithashtu, ndalet në objektivin e qartë dhe pavarësinë e mjaftueshme që i janë dhënë Bankës së Shqipërisë nëpërmjet ligjit të vitit 1997, të cilat sigurojnë një bazë të mirë për aktivitetin e saj. Qartësia e vazhdueshme e misionit të saj, përsosja e mëtejshme e procesit të politikës monetare dhe vëmendja ndaj administrimit të mirë të bankës qendrore, janë thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut dhe realizimin e objektivave të saj që lidhen me politikën.



KONFERENCA VI "TREGJET FINANCIARE RAJONALE DHE STABILITETI FINANCIAR – NJË KONCEPT MIDIS SOVRANITETIT KOMBËTAR DHE GLOBALIZIMIT", TIRANË, 30 - 31 TETOR 2006

Konferenca VI Ndërkombëtare u organizua nga Banka e Shqipërisë në ambientet e hotel "Sheraton" në Tiranë. Punimet u përqendruan në diskutimet që lidhen me stabilitetin financiar dhe rolin e bankave tregtare në arritjen e këtij stabiliteti. Ajo ofroi mundësinë e shkëmbimit të pikëpamjeve ndërmjet aktorëve të ndryshëm në tregun financiar të rajonit të Evropës Juglindore dhe më gjerë, si dhe diskutoi disa nga prirjet më të reja financiare në rajon.

STABILITETI MONETAR DHE FINANCIAR: SFIDAT NË
EVROPËN JUGLINDORE.

LORENZO BINI SMAGHI, Anëtar i Bordit Ekzekutiv, Banka
Qendrore Evropiane.

Misioni i Eurosistemit përfshin promovimin e integritimit financiar evropian, i cili luan një rol të rëndësishëm në transmetimin dhe zbatimin e një politike të vetme monetare për Eurozonën. Në këtë fjalim, autori shpjegon disa prej veçorive specifike të integritimit financiar në Evropën Juglindore dhe sfidave kryesore të politikës monetare dhe të stabilitetit financiar në rajon. Gjithashtu, ai shton disa opinione personale lidhur me përparësitë e vendimmarrësve të politikës monetare, në një kontekst ku kufijve kombëtarë po u vjen fundi.

A PO ZHVILLOHET NJË TREG FINANCIAR RAJONAL?

ARDIAN FULLANI, Guvernator, Banka e Shqipërisë.

Në këtë fjalë, autori trajton ngjashmëritë dhe ndryshimet, por edhe pasiguritë dhe rreziqet që hasin



tregjet financiare në rajon, në rrugën e tyre drejt modernizimit dhe integritimit në tregjet financiare globale. Ai thekson rëndësinë që ka bashkëpunimi rajonal në përballimin sa më mirë të sfidave dhe detyrën e autoriteteve monetare dhe mbikëqyrëse, për të siguruar mjedisin e duhur, për një zhvillim të qëndrueshëm e të balancuar të tregjeve financiare. Është e domosdoshme që këto autoritete të informohen për politikën e grupeve të ndryshme të rëndësishme financiare apo bankare, që operojnë në gjithë rajonin. Në përfundim, autori jep disa mendime rreth bashkëpunimit rajonal praktik.

ANËTARËSIMI I ARDHSHËM NË BE – NJË KATALIZATOR PËR INTEGRIMIN FINANCIAR NË RAJONIN E EVROPËS JUGLINDORE.

ANTONIO DE LECEA, Drejtor për Ekonominë Ndërkombëtare dhe Çështjet Financiare, Komisioni Evropian.

Në kumtesën e tij, autori paraqet në vijë të përgjithshme disa prej karakteristikave më të rëndësishme të procesit të integritimit financiar në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, ai thekson rëndësinë e këtij procesi për tregjet financiare të Evropës Juglindore.

ZHVILLIMI I TREGJEVE FINANCIARE NË BALLKAN: NJË VLERËSIM I PROGRESIT RAJONAL.

J. ANDREW SPINDLER, President dhe Drejtor Ekzekutiv, Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare.

Autori, evidenton në këtë fjalë, arritjet e bashkëpunimit të FSVC-së me bankat qendrore të Ballkanit dhe veçanërisht me Bankën e Shqipërisë, në fushën e sektorit financiar dhe më specifikisht, në drejtim të garantimit të depozitave, të mbikëqyrjes bankare dhe të



sektorit bankar në përgjithësi. F SVC-ja ka bashkëpunuar me bankën qendrore edhe për forcimin e politikave dhe praktikave në fusha të ndryshme, përfshirë atë të operacioneve dhe politikës monetare, kontrollit të brendshëm, pagesave, punës kërkimore dhe teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, në fjalën e tij autori paraqet disa prej elementeve kryesore, të cilat shërbejnë si kushte paraprake për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

SA I INTEGRUAR FINANCIARISHT ËSHTË BALLKANI PERËNDIMOR? NJË ANALIZË PARAPRAKE DHE ÇËSHTJE QË LIDHEN ME POLITIKAT.

EVAN KRAFT, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve, Banka Kombëtare Kroate dhe MÄRKO ŠKREB, ish-Gubernurator, Banka Kombëtare Kroate.

Autorët e hapin kumtesën e tyre duke prezantuar një pamje të përgjithshme makroekonomike të vendeve të rajonit. Ata trajtojnë çështje që lidhen me integrimin financiar dhe tregtinë midis këtyre vendeve. Autorët pasqyrojnë reformat financiare në vendet e rajonit, duke theksuar suksesin e reformave bankare krahasuar me reformat në institucionet jobanka dhe në tregjet e letrave me vlerë.

STABILITETI FINANCIAR NË TRANSFORMIMIN E EKONOMIVE; ROLI I BANKAVE TË HUAJA.

GIUSEPPE CUCCURESE, Kryetar i Rrjetit Ndërkombëtar, San Paolo IMI.

Autori i kësaj fjale, përqendrohet në përvojën e bankave të huaja në Shqipëri dhe më gjerë. Ai thekson faktin që rritja e lartë ekonomike dhe transformimi i shpejtë i sistemit financiar në vendet e rajonit, vjen edhe si rrjedhojë e procesit të integritimit. Gjithashtu, në fjalën e tij autori përmend rolin vendimtar të bankave të huaja, veçanërisht bankat nga



vendet e BE-së, në transformimin e sistemit bankar drejt një sistemi më eficient dhe më të qëndrueshëm.

BANKAT TREGTARE: KONTRIBUESIT MË TË MËDHENJ NË STABILITETIN FINANCIAR.

AGIS LEOPOULOS, Drejtor i Përgjithshëm i Aktiviteteve Ndërkombëtare, Banka Kombëtare e Greqisë.

Në prezantimin e tij, autori thekson rolin dhe kontributin e bankave tregtare në përgjithësi e të atyre shqiptare në veçanti, në stabilitetin financiar të vendit tonë. Ai gjithashtu, flet për bashkëpunimin ndërmjet bankave të huaja me bankierët qendrorë të vendeve pritëse, gjë që në Shqipëri është arritur me sukses. Në vazhdim, autori e ilustron këtë bashkëpunim të suksesshëm, nëpërmjet statistikave të ndryshme të rritjes ekonomike në Shqipëri.

EKSPERIENCA E BANKËS RAIFFEISEN NË EVROPËN JUGLINDORE.

STEVEN GRUNERUD, Drejtor Ekzekutiv, Banka Raiffeisen, Shqipëri.

Në fjalën e tij, autori prezanton eksperiencën e Bankës Raiffeisen në Evropën Juglindore. Ai thekson faktin se ishte njohja dhe përvoja e fituar gjatë hyrjes në tregjet e Evropës Lindore dhe asaj Juglindore, e cila mundësoi parashikimin e ndryshimeve ekonomike dhe rregullatore të tregjeve në këto vende.

ZGJERIMI I BANKAVE ME PRONËSI TË HUAJ NË VENDET EVROPIANE MË EKONOMI NË ZHVILLIM: IMPLIKIME PËR MBIKËQYRJEN.

R. SEAN CRAIG, Departamenti për Çështjet Monetare dhe Kursit të Këmbimit, Fondi Monetar Ndërkombëtar.



Autori, në këtë kumtesë e cilëson zgjerimin e shpejtë të bankave me pronësi të huaj si një tipar-kyç të zhvillimit të sistemeve financiare në shumë vende evropiane, me ekonomi në zhvillim. Gjithashtu, ai shprehet se prania e bankave të huaja në këto vende ka ndryshuar natyrën e rreziqeve të stabilitetit financiar. Kështu, është ulur rreziku i krizës së aftësisë paguese bankare, pasi këto banka janë përgjithësisht banka të mëdha evropiane, që gëzojnë reputacion, administrohen dhe mbikëqyren siç duhet, si dhe kanë një bazë të fuqishme të kapitalit rregullator.

KUSH MBIKËQYR KË? ROLI I RREGULLATORËVE FINANCIARË KOMBËTARË.

BOŠTJAN JAZBEC, Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, Banka e Sllovenisë.

Autori në këtë kumtesë shpreh mendimin e tij se gjatë shpërthimit të krizave financiare mund të rritet nevoja për një arkitekturë të re financiare të tregut të vetëm evropian. Roli i mbikëqyrësve financiarë kombëtarë mund të vihet në dyshim, pasi veprimet bankare dhe shërbimet e tjera financiare janë mjaft të harmonizuara. Ndërkohë që bankat tregtare kalojnë lehtësisht kufijtë kombëtarë, bankat qendrore dhe rregullatorët korrespondues financiarë, e kanë të vështirë të vendosin autoritetin dhe përgjegjësinë e nevojshme për të siguruar stabilitet financiar kombëtar. Kjo është e vërtetë, kryesisht për shtetet e reja anëtare të BE-së dhe për vendet që do të pranohen në BE, të cilat kanë pjesën më të madhe të sektorit financiar në pronësi të huaj. Lind një pyetje urgjente. Kush e ndan barrën e krizës financiare?

RRITJA E STABILITETIT FINANCIAR PËRMES MBIKËQYRJES BANKARE – RASTI I RUMANISË.

VALENTIN LAZEA, Banka Kombëtare e Rumanisë.



Në këtë fjalim, autori prezanton rastin e Rumanisë dhe rritjes së stabilitetit të saj financiar, nëpërmjet mbikëqyrjes bankare. Ai bën një përshkrim të përgjithshëm të sistemit bankar rumun. Gjithashtu, shpjegon edhe masat e marra nga Banka Kombëtare e Rumanisë dhe përkatësisht masat monetare, administrative dhe ato mbikëqyrëse, në mënyrë që të mundësojë përdorimin e masave të mbikëqyrjes së matur, kur ekziston një mjedis me lëvizje të plotë kapitali.

ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR
DHE SFIDAT NË TË ARDHMEN.
KLODION SHEHU, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes,
Banka e Shqipërisë.

Në kumtesën e tij autori jep një pasqyrë të ecurisë së sistemit bankar në Shqipëri, duke u përpjekur që në të njëjtën kohë, të ndajë me pjesëmarrësit disa nga sfidat që industria bankare dhe mbikëqyrësit e saj po hasin në këtë periudhë. Gjithashtu, ai i jep një rëndësi të veçantë komunikimit të vazhdueshëm me tregun financiar dhe rritjes së bashkëpunimit me autoritetet e tjera vendase dhe të huaja si një faktor i rëndësishëm për të garantuar një mbikëqyrje të përshtatshme, për zhvillimin e tregjeve financiare në të gjitha rajonin.

ROLI I STABILITETIT FINANCIAR PËR DREJTIMIN E POLITIKËS
MONETARE.
MEHMET YÖRÜKOĞLU, Zëvendësguvernator, Banka
Qendrore e Republikës së Turqisë.

Në kumtesën e tij, autori i cilëson stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar si parakushte për një mjedis të qëndrueshëm ekonomik. Duke përmendur disa prej krizave financiare turke, të krijuara për shkak

të dobësive makroekonomike në këtë vend, autori përqendrohet në bashkëveprimin ndërmjet politikës monetare dhe stabilitetit financiar. Një sistem i fuqishëm financiar rrit eficiencën e politikës monetare.

POLITIKA MONETARE DHE STABILITETI FINANCIAR.
GEORGE D. DEMOPOULOS, Anëtar i Komitetit të Politikës Monetare, Banka e Greqisë.

Çështjet kryesore që autori trajton në fjalimin e tij janë mjedisi aktual financiar dhe karakteristikat e tij; ndikimi i ndërsjellë i stabilitetit monetar dhe atij financiar. Ai shpjegon lidhjen midis stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit financiar dhe se si këta objektiva të bankës qendrore “ndihmojnë” njëri-tjetrin. Autori flet për rolin e bankave qendrore në stabilitetin financiar.

BASHKËVEPRIMET MIDIS POLITIKËS MONETARE DHE STABILITETIT FINANCIAR: PËRVOJA ÇEKE DHE MËSIMET.
VIT BARTA, Këshilltar i Zëvendësguvernatorit të Parë, Banka Kombëtare Çeke.

Në këtë kumtesë, autori trajton lidhjen ndërmjet zhvillimit të sektorit bankar nga njëra anë dhe zhvillimit makroekonomik dhe monetar, nga ana tjetër. Në mënyrë më specifike, ai paraqet fakte themelore për të dyja fushat, lidhur me periudhën para krizës (1990-1996) dhe më pas, trajton etapat kryesore gjatë krizës të monedhës dhe krizës të sektorit bankar (1997-1999), si dhe flet për reagimin e tregut ndaj politikës monetare të ndërmarrë nga politikëbërësit. Autori sqaron pasojat e krizës binjake dhe kostot e hasura.

ÇËSHTJE QË LIDHEN ME MBIKËQYRJEN NGA AUTORITETI PRITËS NË VENDET E EVROPËS JUGLINDORE. PSE ËSHTË



BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE PRITËSE I DËSHIRUESHËM DHE SI TË BËHET E MUNDUR ARRITJA E TIJ?
LUIGI PASSAMONTI, Këshilltar i lartë, Zyra e Zhvillimit të Sektorit Financiar dhe Privat, Zëvendës-president, Banka Botërore; FRANCO BRUNI, Profesor i Ekonomisë Monetare Ndërkombëtare, Universiteti Bocconi, Itali dhe BB-Programi i Kovergjencës dhe PETER NICHOLL, Anëtar i Bordit Drejtues, Banka Qendrore e Bosnjë-Hercegovinës.

Në fjalimin e tyre, autorët cilësojnë bashkëpunimin e autoriteteve mbikëqyrëse të vendit-pritës dhe selive qendrore të bankave shumëkombëshe, si një faktor të rëndësishëm të bashkëpunimit rajonal. Në këtë kuadër, ata sugjerojnë që mbikëqyrësit rajonalë të një vendi të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të konsiderojnë problemet e hasura në një vend nga këndvështrimi i një vendi tjetër, për të bërë krahasime dhe për të nxjerrë mësimë reciproke.

KREDITË E PAZAKONTA HIPOTEKARE.

ALLEN FRANKEL, Këshilltar, Departamenti Ekonomik dhe Monetar, Banka për Rregullime Ndërkombëtare.

Në fjalën e tij, autori merr si pikë referimi sistemin më të përparuar në dhënien e kredive për strehim, atë të Shteteve të Bashkuara. Ai paraqet një pasqyrë të plotë se si ndryshimet e teknologjisë ndikuan në organizimin industrial të financimit të hipotekave në këtë vend, në vitet 1990. Kështu, ai bën një krahasim të karakterit të financimit të hipotekave në Shtetet e Bashkuara në fillim dhe në mes të viteve 1990, me vitin 2006.

PERSPEKTIVA E AUSTRISË SI NJË VEND-MËMË DHE PRITËS.

MICHAEL WÜRZ, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Analizës së Tregjeve Financiare, Banka Kombëtare e Austrisë.



Autori paraqet një pamje të përgjithshme të rolit mbikëqyrës, sipas përvojës së Oesterreichische Nationalbank (OeNB), e cila është e përfshirë në mbikëqyrjen e disa institucioneve të veçanta financiare. Ai gjithashtu, e cilëson shumë të rëndësishëm bashkëpunimin në fushën e mbikëqyrjes dhe shkëmbimin e informacionit, i cili është në interes të mbikëqyrësve të vendit mëmë dhe atij pritës, dhe duhet t'i shërbejë interesave të të dyja palëve.

SI TË PËRMIRËSOJMË BASHKËPUNIMIN NË TË ARDHMEN.
RADOVAN JELAŠIĆ, Guvernator, Banka Kombëtare e Serbisë.

Në fjalën e tij, autori prezanton disa mendime rreth rëndësisë dhe rolit të mbikëqyrjes bankare. Ai thekson dobinë e ndarjes së eksperiencave midis mbikëqyrësve nga vende të ndryshme. Një konkluzion tjetër, që autori nxjerr në fjalën e tij është roli i mbikëqyrësve bankarë për të siguruar qytetarët që kursimet e tyre ndodhen në banka të sigurta dhe të shëndetshme.

KEMAL KOZARIĆ, Guvernator, Banka Qendrore e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Bankat qendrore, si autoriteti i vetëm monetar me detyrë primare ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe të atij financiar në vend, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e integritimit evropian dhe bashkëpunimit rajonal. Bankat qendrore në rajon, janë të gatshme të bashkëpunojnë në shumë projekte të rëndësisë së lartë për ekonominë – brenda vendit dhe brenda rajonit. Në fjalimin e tij, autori veçon disa probleme dhe tendenca në rajon, të cilat janë në interes të përbashkët, si dhe përmend drejtimet ku mund dhe duhet të krijohet një bashkëpunim më i ngushtë.



LJUBIŠA KRGOVIĆ, Guvernator, Banka Kombëtare e Malit të Zi.

Në fjalën e tij, autori vë theksin mbi transformimin radikal dhe zgjerimin e vullshëm që kanë pësuar tregjet dhe institucionet financiare gjatë dekadave të fundit. Kjo u nxit më tepër nga një tendencë e përgjithshme derregullimi, liberalizimi, globalizimi dhe nga progresi i teknologjisë të informacionit. Flukset ndërkombëtare të kapitalit janë intensifikuar; tregjet kanë zhvilluar instrumente të reja dhe të sofistikuara; shpejtësia e kryerjes së transaksioneve financiare është rritur ndjeshëm, duke ulur mjaft kostot e tyre.

MICHEL SVETCHINE, Drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës.

Autori bën disa komente personale për bashkëpunimin rajonal duke u shprehur për mbikëqyrjen me sukses të institucioneve bankare të krijuara. Ai gjithashtu, nxjerr në pah çështje të marrëdhënieve asimetrike ndërmjet mbikëqyrësve të vendit-mëmë dhe të vendit-pritës. Autori përgëzon bashkëpunimin ndërmjet Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës dhe mbikëqyrësve nga Shqipëria, dhe e cilëson eksperiencën e përfituar shumë frytdhënëse.

PETAR GOSHEV, Guvernator, Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë.

Sistemet bankare dhe financiare në vendet e rajonit kanë kaluar një proces të ngjashëm reformash të shumta, në mos të njëjtë. Gjithashtu, sistemet bankare kanë strukturë dhe karakteristika shumë të përafërta dhe për rrjedhojë, të gjithë hasin sfida dhe çështje të së njëjtës natyrë në drejtim të politikës monetare. Autori



nxit diskutime lidhur me sfidat me të cilat përballet sistemi financiar në ditët e sotme, si dhe lidhur me pyetjen si të bashkëpunohet më mirë dhe pse aktualisht duhet të ekzistojë një bashkëpunim i frytshëm në rajon.

BOTIME EDUKATIVE

FLETËPALOSJE PËR PRODUKTET E BANKAVE TREGTARE

Janë një set fletëpalosjesh të cilat përshkruajnë produktet dhe format e ndryshme të tyre, të ofruara nga bankat tregtare për publikun shqiptar. Këto fletëpalosje përmbajnë informacion për format kryesore të depozitimit si: llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat dhe çertifikatat e depozitave si dhe informacion rreth kredive dhe si mund të aplikohet për ato, kartave të kreditit dhe debitit dhe kushtet e përfitimit dhe përdorimit të tyre.

Ç'ËSHTË PËR JU STABILITETI I ÇMIMEVE?

Kjo broshurë përshkruan në mënyrë të thjeshtë dhe të detajuar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe rëndësinë e saj për ekonominë e një vendi. Në tekst, do të gjeni shembuj të cilët janë marrë nga jeta e përditshme. Kjo broshurë shpjegon edhe konceptet e inflacionit e të deflacionit dhe ndërlikimet që ato sjellin në jetën e secilit.

BANKAT QENDRORE TË RAJONIT

Nëpërmjet një rrëfimi copëzash të historive të bankave të rajonit tonë, kjo broshurë synon të japë një panoramë të përgjithshme të asaj çka bën një bankë qendrore. Bankat janë si njerëzit: kanë jetët e historitë e tyre tipike, kuriozitetet, të thënat e të pathënat, rriten, ndryshojnë,



transformohen, zhvillohen, kanë veçoritë e tyre që i dallojnë nga njëra-tjetra, por në thelb mbeten të njëjta.

PËRSE DUHET TË KENI NJË BUXHET PERSONAL?

Buxheti mund të konsiderohet si hapi i parë për të arritur qëllimet tuaja financiare. Ai ju ndihmon të kontrolloni shpenzimet tuaja, duke krijuar mundësi që të shtoni kursimet. Në një farë mënyre buxheti është ndërgjegja juaj financiare. Ai tregon se sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.

DEPARTAMENTET NË BANKËN E SHQIPËRISË

“Departamentet në Bankën e Shqipërisë” i ribotuar, ju sjell informacion të rinovuar mbi disa ndryshime të bëra në Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që risjell në vëmendjen e të gjithëve, një prezantim të bërë edhe më parë mbi detyrat dhe funksionet tashmë të konsoliduara, të pjesës tjetër të Bankës.

BORXHI DHE KREDIA = NJË ÇËSHTJE INTERESI

Borxhi ka ekzistuar që në kohët e mesjetës dhe deri në ditët tona. Ai ka marrë forma të ndryshme duke u zhvilluar në atë që ne e njohim sot me emrin kredi. Kjo broshurë informon publikun mbi format e ndryshme të kredive dhe si mund të aplikohet për një të tillë.

NË PRITJE TË REGJISTRIT TË KREDIVE

Duke pritur që edhe Shqipëria të ketë Regjistrin e saj të parë të Kredive, Banka e Shqipërisë publikon këtë broshurë, e cila synon t’i shpjegojë publikut se çfarë është



një regjistër kredie, si funksionon ai, ç'loj informacioni përmban dhe mbi të gjitha përse krijimi i tij është një domosdoshmëri për situatën aktuale shqiptare.

RAPORTI VJETOR

PUBLIKIME PERIODIKE

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë përmban një analizë të gjendjes ekonomiko-financiare të vendit si dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë një viti. Ai gjithashtu, bën një përshkrim të zhvillimeve në ekonominë botërore dhe impaktin e saj mbi ekonominë vendase; të zhvillimeve në tregjet monetare, mbikëqyrjen bankare si dhe të veprimtarive të tjera të Bankës së Shqipërisë; pasqyrat dhe llogaritë financiare, të shoqëruara nga opinionioni i kontrollorëve, lidhur me gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

RAPORTET E POLITIKËS MONETARE

Vendimmarrja politike e Bankës së Shqipërisë është një e drejtë ekskluzive e Këshillit Mbikëqyrës së saj. Ky proces vendimmarrjeje bazohet në analizat dhe në parashikimet që çdo muaj të vitit janë pjesë e njërit prej raporteve të mëposhtme të politikës monetare:

- 1. Raporti Muajor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare për dy muajt e ndërmjetëm të çdo tremujori. Një vend të rëndësishëm përbën qëndrimi që duhet mbajtur në të ardhmen.*
- 2. Raporti Tremujor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare për tremujorin e parë dhe për nëntëmujorin. Një vend të rëndësishëm përbën qëndrimi që duhet mbajtur në të ardhmen.*
- 3. Raporti Gjashtëmuajor i Politikës Monetare. Ky*



raport analizon dhe vlerëson zhvillimet ekonomike e financiare të ekonomisë shqiptare gjatë gjashtë muajve të parë ose të fundit të një viti të caktuar. Në varësi të këtyre zhvillimeve, të ndikimit të tyre në inflacionin e periudhës së shqyrtuar dhe të pritjeve për të ardhmen jepet dhe qëndrimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

4. Dokumenti i Politikës Monetare. Është një përmbledhje e thjeshtuar e politikës monetare, që Banka e Shqipërisë do të ndjekë.

RAPORTI STATISTIKOR

Raporti Statistikor është botim i përmuajshëm që përgatitet nga Departamenti i Statistikës dhe përmban të dhëna për sektorin real, sektorin financiar, sektorin fiskal dhe sektorin e jashtëm.

BULETINI ZYRTAR

Buletini zyrtar është botim që përgatitet jo më pak se një herë në muaj dhe përmban të gjitha vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me përjashtim të atyre që kanë karakter sekret ose konfidencial, rregullore, deklarata, opinione, rekomandime si dhe çdo akt tjetër me karakter të përgjithshëm, që gjykohen të përshtatshme për t'u botuar.

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES

Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes përgatitet nga Departamenti i Mbikëqyrjes dhe përmban: një analizë vjetore të veprimtarisë së sistemit bankar dhe të



mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë; një kuadër të plotë të ndryshimeve rregullatore mbikëqyrëse në përshtatje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare; statistika dhe informacione mbi subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë si dhe çështje të ecurisë së sistemit bankar.

BULETINI VJETOR I BILANCIT TË PAGESAVE

Buletini Vjetor i Bilancit të Pagesave analizon hollësisht zhvillimet e sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare, për vitin përkatës. Në këtë botim, bëhet një analizë e bilancit të pagesave sipas zërave të veçantë të llogarisë korente dhe llogarisë kapitale dhe financiare. Ai përmban analiza të detajuara të zhvillimeve në tregtinë e jashtme sipas grupmallrave dhe shteteve, analiza të ecurisë së shërbimeve, të të ardhurave, të transfertave korente dhe transaksioneve në llogarinë kapitale dhe financiare. Nëpërmjet një përshkrimi sintetik, ofron për përdoruesit e pasqyrës së bilancit të pagesave njohje me konceptin “bilanc pagesash”, duke prezantuar njëkohësisht burimet dhe metodologjinë e përdorur në hartimin e Bilancit Shqiptar të Pagesave. Buletini përmban, gjithashtu, një aneks statistikor ku do të gjeni seri kohore të dhënash për zërat kryesorë të bilancit të pagesave.

ARTIKUJ TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË TË PUBLIKUAR NË PERIODIKË TË NDRYSHËM

OMGJ-TË, MREKULLI E SHKENCËS APO APOKALIPS I NJERËZIMIT.

ADRIAN CIVICI, gazeta “ABC” , 7 janar 2006.



SHQIPËRIA E 100-TA.

ADRIAN CIVICI, revista "Monitor", 11 janar 2006.

MBI INFORMACIONIN DHE EKONOMINË E DIJES.

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 21 janar 2006.

RRITJA E KREDISË PËR EKONOMINË, BURIMI KRYESOR I ZGJERIMIT MONETAR.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 22 janar 2006.

BSH: NË 2006 INFLACIONI DO TË JETË 3%.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 27 janar 2006.

RRITJA EKONOMIKE DHE E ARDHMJEA.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Tirana Observer", 27 janar 2006.

RRITJE EKONOMIKE PA ZHVILLIM.

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 28 janar 2006.

VENDI DUHET T'I PËRGATISË VETË POLITIKAT EKONOMIKE.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Biznesi", 31 janar 2006

SI HUMBËM NGA GLOBALIZMI.

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 11 shkurt 2006.

PASIGURIA E DOLLARIT AMERIKAN; EKONOMIA, RREZIQET E 2006-ËS.

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 18 shkurt 2006

INFORMACIONI MBI TREGJET, ÇELËSI I SUKSESIT PËR BIZNESET NË KOHËT MODERNË.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia" 19 shkurt 2006.

SHQIPTARËT "PËRBALLË" UJIT.

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 25 shkurt 2006

REMITANCAT: EMIGRACIONI SHQIPTAR NË ITALI SI RAST STUDIMI.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 7 mars 2006.

REMITANCAT NJË MUNDËSI PËR RRITJE.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Tirana Observer", 7 mars 2006.



DISEKUILIBRAT E REZERVËS FEDERALE AMERIKANE.
SABAH HILMIA, gazeta "Korrieri", 9 mars 2006.

SFIDA E LUFTËS KUNDËR VARFËRISË NË SHQIPËRI.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 18 mars 2006.

STUDENTËT DHE BANKINGU QENDROR.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Tirana Observer", 24 mars 2006.

BSH-GTZ: TË NXITET MENDIMI SHKENCOR NË SISTEMIN
BANKAR.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 24 mars 2006.

DOBIA E LEKSIONEVE PUBLIKE MBI EKONOMINË.
ARDIAN FULLANI, gazeta "55", 24 mars 2006.

KEYNES OSE SHPIRTI I PËRGJEGJËSISË PUBLIKE.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 8 prill 2006.

EKONOMISTËT PËRBALLË EKOLOGJISTËVE.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 6 maj 2006

RRUGA E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË RAJON.
SABAH HILMIA, gazeta "Ekonomia", 10 maj 2006.

KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT NË FUNKSION TË MJEDISIT
EKONOMIK.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 12 maj, 2006.

POLITIKAT EKONOMIKE DHE LOGJIKA "RACIONALE" E
TREGUT; EKONOMIA REALE, PRIORITET NDAJ TREGJEVE
FINANCIARE.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 13 maj 2006.

RRITJA E KREDIVE PARAQET RREZIQE POR JO DERI TEK
INFLACIONI.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 26-28 maj 2006.

EDUKIMI DHE EKONOMIA NË RELACION PROBLEMATIK.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 27 maj 2006.

KREDIA BANKARE, OKSIGJENI I EKONOMISË



SABAH HILMIA, "Gazeta Shqiptare", 30 maj 2006.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE ENDE NUK ËSHTË
VËNË NË PROVË.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 31 maj 2006.

EKONOMIA E KOSOVËS, PIKËPYETJA E MADHE PËR ZHVILLIMIN
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 3 qershor 2006.

BANKA E SHQIPËRISË PO RRIË MBIKËQYRJEN
RREGULLATORE TË SISTEMIT BANKAR.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 6 qershor 2006.

NGA BASHKIMI EVROPIAN DREJT "EUROLAND-IT"
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 10 qershor 2006.

EKONOMIA PËRBALLË UNIVERSITETIT DHE SHKENCËS.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 17 qershor 2006.

GARANTIMI I RRIËTJES EKONOMIKE ME POLITIKA TË
KOMBINUARA.

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 24 qershor 2006.

RRIËTJA E NORMËS SË INTERESIT, FRENON INFLACIONIN.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 14 korrik 2006.

ALTERGLOBALIZMI – PROTESTË SOCIALE APO FILOZOFI
ALTERNATIVE?

ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 22 korrik 2006.

STABILITETI DHE GJENDJA MAKROEKONOMIKE.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Tirana Observer", 25 korrik 2006.

RRIËTËM NORMËN E INTERESIT QË TË SHPËTOJMË NGA
INFLACIONI.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 26 korrik 2006.

DOBËSIA QË PENGON ZHVILLIMIN.

ADRIAN CIVICI, revista "Monitor", 26 korrik 2006.

RRIËTJA EKONOMIKE, SFIDA MË E MADHE E SHQIPËRISË.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 29 korrik 2006.



PASIONI "SAMUELSON" DHE KEQINTERPRETIMI I TIJ.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 5 gusht 2006.

SHQIPËRIA, NJË VEND ME BARRË FISKALE TË LARTË APO ...?
SABAH HILMIA, "Gazeta Shqiptare", 11 gusht 2006.

GLOBALIZIMI APO FUNDI I AVANTAZHEVE KRAHASUESE.
ADRIAN CIVICI, gazeta "ABC", 19 gusht 2006.

SHQIPËRIA 1 EURO, MUNGOJNË LIGJET.
SABAH HILMIA, "Gazeta Shqiptare", 29 gusht 2006.

AKCIZAT MBARTIN EDHE PRIRJE POTENCIALE
INFLACIONISTE.
SABAH HILMIA, "Gazeta Shqiptare", 18 gusht 2006.

BUJQËSIA, NEVOJË PËR MBËSHTETJE FINANCIARE.
SABAH HILMIA, "Gazeta Shqiptare", 12 shtator 2006.

EKONOMIA KËRKON INVESTIME TË HUAJA DIREKTE.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 16 shtator 2006.

ALBANIAN ECONOMY: ADVANTAGES AND INCENTIVES.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Tirana Times", 29 shtator 2006.

DËSHIRA DHE FLUKSI I MUNGUAR I INVESTIMEVE TË
HUAJA NË SHQIPËRI.
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 5 tetor 2006

MUHAMMAD YUNUS, BANKIERI I TË MJERËVE.
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 15 tetor 2006.

INVESTITORËT DHE BANKAT T'I KONCEPTOJNË
STRATEGJITË NË NIVEL RAJONAL, JO TË FRAGMENTUARA.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 31 tetor 2006.

STABILITETI FINANCIAR SI MALL PUBLIK.
ARDIAN FULLANI, gazeta "Albania", 31 tetor 2006.

"KAPITALI SOCIAL"- DOBËSIA QË NA FRENON ZHVILLIMIN.
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 5 nëntor 2006.



EVROPA JUGLINDORE SË BASHKU PËR STABILITETIN FINANCIAR.

ARDIAN FULLANI, revista "Monitor", 8 nëntor 2006.

PËRBALLË GLOBALIZMIT-SI PËRFITUES APO SI HUMBËS.

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 20 nëntor 2006.

REFORMAT NË SISTEMIN BANKAR, ARRITJET DHE SFIDAT.

FATOS IBRAHIMI, gazeta "Ekonomia", 24 nëntor 2006.

RRITET NORMA BAZË E INTERESIT PËR TË AMORTIZUAR INFLACIONIN.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 1 dhjetor 2006.

KONTROLLI MBI INFLACIONIN, BSH NGRE ME 0,25% NORMËN BAZË TË INTERESIT.

ARDIAN FULLANI, Gazeta "55", 1 dhjetor 2006.

INDEKSET E BESIMIT RRISIN INVESTIMET E HUAJA.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 2 dhjetor 2006.

SHTETI APO TREGU - KUSH NA E GARANTON ZHVILLIMIN?

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 3 dhjetor 2006.

POLITIKA E DOLLARIT TË FORTË.

SABAH HILMIA, "Gazeta Shqiptare", 6 dhjetor 2006.

BANKAT QENDRORE, BASHKËPUNËTORE PËR REFORMAT.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 9 dhjetor 2006.

OBJEKTIVI KRYESOR , RUAJTJA E STABILITETIT TË ÇMIMEVE.

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 10 dhjetor 2006.



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



publikime

të Bankës së Shqipërisë

Shënime

*Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike
në adresën:*

www.bankofalbania.org

*Gjithashtu në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 1000 kopje

